



**BLERIM DESTANI**  
NGA PASIONI NE-PROFESIONI

**matca**

albanian nightlife

- ERLETA HOTI
- AVNI ABAZI
- NORA GASHI
- ORINDA HUTA
- RESUL SINANI
- ELIDA KRYEZIU
- EKREM SOPI
- ARTNESA KRASNIQI
- LIRIJE SOPI

dyjavore nr. 13 • 15 janar 2009 • [www.tung.ch](http://www.tung.ch)

# Puna në "vetvete" është e pandërprerë...

**Aktori tetovar Blerim Destani, e shndërroj pasionin e tij në profesion dhe me këmbëngulje ka realizuar planin e tij duke u marrë intensivisht me temat e filmit dhe të dramës. Pasionin e tij për aktrimin Blerimi e zbuloi herët. Që në moshën 14 vjeçare ka bërë sprovën e parë në botën e aktrimit dhe vazhdimisht ka punuar në vetveten. Për aktrimin, rolet e tij dhe çështjeve të tjera flasim me Blerimin...**

Blerimi është lindur në vitin 1981 në Stollberg të Gjermanisë, ndërsa fëmijërinë e kaloi në Tetovë. Pasionin e tij për aktrimin e zbuloi që herët kështu që filloi të merret intensivisht me temat e filmit dhe të dramës. Krahas prodhimit të metrazheve të shkurtra dokumentare, filloi edhe shkollimin e mjeshtërisë së aktorit në Kelln dhe në Londër. Në vitin 2004, Blerimi realizoi rolin kryesor Beni, në filmin televiziv „Metropol“ (regji: Sunaj Raça). Ai tërhoqi vëmendjen e publikut në Evropën Juglindore, veçanërisht me temat që trajtonte. Në vitin 2005 me filmin artistik „Kosova – Desperate Search“ (Etjet e Kosovës) realizoi rolin e Ushtarit. Filmi trajton pasojat dhe ndikimet e luftës së Kosovës në popullsinë shqiptare. Suksesin e madh ia solli Shestani roli kryesor, në filmin „Koha e kometës“ me skenar dhe regji të Fatmir Koçit, film që u realizua si produksion i kompanisë L.A.R.A. Enterprises. Me rolin e Shestanit Blerimi bëri një rrumbullakim të përvojës së deritanishme të tij duke e kurorëzuar me një figurë markante të kryepersonazhit. Në rolin e Shestanit Blerimi solli një prezencë të fuqishme në ekranet e kinemave duke e dëshmuar potencialin e tij aktorsk. Pikërisht realizimi i Shestanit për Blerimin ishte më shumë se sa një sukses i zakonshëm në një film. Në festivalin ndërkombëtar të filmit në Durrës, filmi "Koha e kometës" fitoi çmimin "Golden Gladiator for Best National Film".

**Hapat e parë në film keni bërë në Maqedoni. Na tregoni, se si keni hyrë në fushën e filmit në Gjermani?**

Unë jetoj në Gjermani. Në tri projektet e mia të deritanishme është trajtuar tema shqiptare. Pra, unë merrem me këto tema pasi i ndjej se janë gjëra që duhet të trajtohen. Në Gjermani vepron edhe kompania ime "LARA Enterprises" që edhe i ka prodhuar këto projekte. Pas filmit të tretë "Koha e kometës" mua më erdhën shumë oferta edhe në projekte ndërkombëtare, këto oferta më erdhën si aktor që jeton dhe vepron në Gjermani. Kuptohet, në punën time unë nuk e fsheh prejardhjen time kombëtare, përkundrazi e theksoj këtë,

pasi mendoj se kjo është një vlerë e imja plus që e kam për dallim nga kolegët gjermanë. Në të ardhmen e afërt do të paraqitem edhe në role ku do të luaj personazhe gjermanë. Dhe, shpresoj që në ato role, do të jem po ashtu i suksesshëm si në filmat me tema shqiptare.

**Bashkëpunoni më menaxherin e mirënjohur gjerman-boshnjak Alain Midzic. Si dhe kur u krijuar kjo lidhje?**


Pas përfundimit të filmit "Etjet e Kosovës" unë dëshiroja të bëj disa ndryshime në kompani, ku theks të veçantë ti jepja menaxhimit në sferën e artit dhe show biznesit. Kështu u njoftova me Alain Midzic, ai më bëri një ofertë që mua më pëlqeu. Me ardhjen e tij, LARA u bë menaxhuese e disa aktorëve, modeleve, sportistëve si dhe e disa spektakleve televizive. Në atë kohë edhe i filluam përgatitjet për filmin "Koha e kometës".

**Kompania „Sharr Turist“, udhëhequr nga babai juaj Lazim Destani, pas 20 vjetorit të themelimit, është transformuar në tri kompani të tjera. Kompania L.A.R.A. Enterprises udhëheqet nga ju. Çfarë fshihet prapa kompanisë LARA?**

Prapa LARA Enterprises nuk fshihet asgjë. Është kompani që është e pranishme në tregun gjerman. Prodhon filma, të cilët tashmë janë bërë letërnjoftimi i saj. Pasi përmendët "Sharr Turistin", më duhet të them se LARA ka një obligim ndaj asaj kompanie pasi bazuar në përvojën dhe autoritetin e prindërve të mi, edhe LARA vazhdon të veprojë me të njëjtën energji dhe përkushtim ndaj punës ashtu siç vepronte "Sharr Turisti". Fundja unë kam trashëguar nga prindërit e mi pikërisht atë energji dhe përkushtim ndaj punës.

**Filmi „Koha e Kometës“ vërtetë ka bërë boom në kinematografinë shqiptare, ngase ishte filmi më i shtrenjtë shqiptar. Si dhe kur lindi ideja për këtë film?**

Suksesi i filmit "Koha e kometës" nuk është bazuar vetëm në faktin që është filmi më i shtrenjtë shqiptar. Unë do të kisha thënë që ishte produksioni më i organizuar i ndonjë filmi shqiptar. Pasi



jemi përkujdesur që çdo komponent e filmit të mbulohej me njerëz profesionist, njerëz që respektojnë para së gjithash punën e tyre. Kështu u krijua një ekip i mirëfilltë që mori mbi supet e veta gjithë barrën e rëndë të filmit dhe çdo gjë rrodhi sipas planit dhe qëllimeve të parashtuara. Ndërsa ideja për filmin lindi që në momentin kur unë për të parën herë e lexova skenarin. Krijova një interakcion të fuqishëm me Shestanin. Gjatë leximit të skenarit në shumë momente e shihja veten, thjeshtë ishte sikur po lexoja diçka që e kisha njohur që më parë. Pastaj, edhe pasuan hapat tjerë që

sollën si rezultat edhe filmin.

**„Koha e Kometës“ është bazuar në romanin „Viti i mbrapsht“ të Ismail Kadarese. Çfarë janë vlerësimet për filmin që keni pranuar nga Kadare?**

Me z. Ismail Kadarenë kam pasur nderin të takohem disa herë. Herën e parë kur ishim në fazën përgatitore të filmit, dhe pastaj u takuam edhe në Paris, ku e kemi parë bashkë një nga versionet e para të montazhit të filmit. Mund të them që z. Kadare përveç që është një artist i madh, ai është edhe një njeri i madh. Përshtypjet e tij për filmin janë shumë pozitive, pasi ai e

njuh shumë mirë gjuhën e filmit dhe kërkesat që ka kinematografia për dallim nga letërsia.

**Tani kenë qen i angazhuar në disa projekte ndërkombëtar filmash. Mundësisht na tregoni më gjerësisht.**

Në filmin "The Truth About Men" luajta rolin e një dirigjenti të orkestrës simfonike të Zelandës së Re. Fjala është për një komedi të zezë, diçka ngjashëm si filmi "Closer", ku nëpërmjet situatave komike dalin në pah dramati më të dhimbshme në raportet ndërnjerëzore. Personazhi kryesor që luhej nga aktorja Rhona Mitra, bie në dashuri me këtë dirigjent duke dashur të ik nga situatat e saja të ndërlikuara me ish burrin e saj. Besoj që filmi do të ketë sukses, pasi nëpërmjet një lloji humori të zi, tregon dramati më të thella njerëzore. Ndërsa në filmin "At World's End" luajta rolin e një kameramani gjerman (Rudy Huber). Fjala është për një film të zhanrit triler/aksion ku një ekip televiziv duke xhiruar një film dokumentar në xhungël, hasin në një lule të veçantë e cila besohet se po qese njeriu i hanë petalet e saj do të ketë jetë të amshueshme. Ekipi televiziv has në këtë lule në mes të xhunglës duke mos e ditur se në kërkim të po të njëjtës lule janë vënë shumë aventurier dhe mercenarë nga të katër anët e botës. Filmi është përplot me skena aksioni si dhe me shumë efekte speciale.

**Ku ishte dallimi të punosh me një staf ndërkombëtar- ndoshta edhe më profesional, krahas me stafin shqiptar?**

Në secilin sektor të produksionit dallimi është shumë i madh dhe nuk mund as të bëhen krahasime. Atje fjala është për një industri kinematografike ku çdo gjë është planifikuar dhe detajuar deri në imtësitë më të vogla, ndërsa tek

ne ende bazohemi në entuziazëm. Në koproduksionet ndërkombëtare aktori vërtetë e ndjen me plot kuptimin e fjalës rëndësinë që ka në film. Pasi sheh se gjithçka është përgatitur në shërbim të skenës në të cilën duhet vet ai të veproj. Kështu që aktori nuk mendon për asgjë tjetër veçse të punës së tij kreative. Nuk mund të thuhet që ne nuk kemi staf profesional, por ende na mungojnë projektet ku shumë njerëz, që vërtetë janë profesionist do të dëshmojnë veten dhe më pas, nga projekti në projekt, edhe do të mund të profilojnë më mirë duke i shtuar edhe aftësitë profesionale.

**Për projekte ndërkombëtar duhet njohja e gjuhës angleze. Ju, siç treguat më parë, kenë qenë në Angli për ta përvetësuar gjuhën. A mjafton kjo, pasi kenë qëndruar vetëm gjashtë muaj?**

Në këtë profesion asnjëherë nuk mund të thuash se u bë mjaft. Në çdo fazë e ndjen nevojën se duhet edhe diçka më shumë e më shumë. Por në kushtet bashkëkohore edhe këto gjëra plotësohen. Në raport me ofertat dhe peshën e tyre që kanë, unë angazhoj "couch" për çdo gjë që mendoj se duhet arritur. Ky është një standard dhe një traditë në kinematografi. Dhe është shumë e suksesshme, pasi gjatë punës fokusohesh në gjërat që të duhen dhe në njëfarë mënyre arrin më shpejtë tek ajo që në fakt edhe të duhet.

**Si aktor ju duhet të punoni vazhdimisht në "vetveten". Çfarë bëni ju? Merrni mësim aktrimesh, apo diçka të ngjashëm?**

Puna në "vetveten" është e pandërprerë. Aktori ynë Bekim Fehmiu e ka dhënë definicionin më të mirë për aktorin: "Aktori është një minator që gjithmonë gërmon brenda vetes së tij". Unë jam

shumë dakord me këtë mendim të aktorit tonë të madh, pasi në të vërtetë ashtu edhe është. Në çdo projekt aktorit i duhet prej fillimit t'i fillojë përgatitjet, e ato fillojnë duke gërmuar më thellë e më thellë brenda vetes. E thash më lartë që angazhimi i "couch-ve" është shumë dobiprurës pasi prej tyre e merr gjithë përvojën e tyre në këtë profesion, dhe e sheh se çfarë tunele të reja duhet të çelësh brenda vetes.

**Çfarë planifikoni për vitin 2009?**

Jam në përgatitje për filmin "Get low" që do ta xhiroj në SHBA. Tani për tani për dy projekte i kemi përmbyllur marrëveshjet, ndërsa për dy projekte tjera jemi ende në negociata. Shpresoj që para publikut do të paraqitem në të njëjtën mënyrë dinjitoze, ashtu siç ishte me "Kohën e kometës".


**A do të na sillni në vitin 2009 projekte kombëtare, ngase adhuresit tuaj presin me pa durim?**

Kuptohet. Unë sado që të bëj projekte ndërkombëtare, projektet që më së shumti më sjellin kënaqësi, janë projektet tona kombëtare. Në kohët e fundit jam duke u marr me temat e emigracionit, pra me jetën e shqiptarëve në Evropë, si dhe jemi fazë bisedimesh për të marr pjesë në një projekt plotësisht me temë kombëtare. Të shpresojmë se të gjitha planet do t'i realizojmë.

**Këshilli juaj për të rinjtë, të cilët po ashtu ëndërrojnë të hyn në fushën e kinematografisë....**

Të mundohen përherë të jenë vetvetja, të mos mundohen të fshehin prejardhjen e tyre kombëtare për të qenë të pëlqyeshëm nga të tjerët. Duke qenë vetvetja, ke përherë se ku të mbështetesh, në çdo punë që e bën.

**Intervistoi: Elife Kurteshi**



Reklamë